



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 12220 Prot
mbledhja nr. 7/2019

Shkodër, më 12.07.2019

N J O F T I M

për thirrjen e mbledhjes së këshillit bashkiak

Të nderuar këshilltarë,

Në mbështetje të nenit 53 pika 2, pika 4; nenit 56 pika 2 shkronja "a" të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", njoftoj thirrjen e mbledhjes së radhës së Këshillit Bashkiak Shkodër, ditën e **Enjte, datë 18 Korrik 2019, ora 18:00**, në sallën e mbledhjeve të këshillit bashkiak, me rend dite si më poshtë:

1. Pr/ Vendim: "Për propozim për dhënien e ndihmës ekonomike për muajin Korrik 2019".
2. Pr/ Vendim: "Për dhënien e paaftësisë dhe invaliditetit të punës për muajin Korrik 2019", "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Qershor 2019", dhe "Për miratimin e kompensimit të çmimit të energjisë elektrike për kategoritë përfituese të ndihmës ekonomike, për muajin Qershor 2019".
3. Pr/ Vendim: "Për miratimin e projektit të parë të programit buxhetor afatmesem 2020-2022 të bashkisë Shkodër". (rishqyrtim)
4. Pr/ Vendim: "Për disa ndryshime në VKB nr. 82, datë 20.12.2018 dhe rishpërndarje të fondeve". (rishqyrtim)
5. Pr/ Vendim: "Për miratimin e përdoruesve faktikë dhe subjekteve përfituese të tokës bujqësore që plotësojnë kushtet ligjore për tu pajisur me AMTP (pronësi), në fshatin Pentar, njësia administrative Dajç, bashkia Shkodër.
6. Pr/ Vendim: "Për ndryshimin e pjesëshëm të VKB nr. 51, datë 14.04.2009 "Për miratimin e listës së pjesëshme të pronave të paluajtëshme shtetërore që kërkohen për transferimin në pronësi të Bashkisë Shkodër", për heqjen nga lista e pasurive të transferuara në pronësi të bashkisë Shkodër, miratuar me VKM nr. 421, datë 2.6.2010, të ndryshuar", të pronave me nr rendor 45, 58, 65, 109, sipas formularit

për heqjen nga inventari i pronave të paluajtëshme shtetërore“. (shtyrë nga mbledhja e kaluar).

7. Pr/ Vendim: “Për dhënie pëlqimi për miratimin e vazhimit të dhënies më qira (procedurë konkurruese) me afat 5-vjeçar për objektin “Njësia thertores (therje kafshëve) ndodhur në ZK 1495, Dobraç-Njësia Administrative Rrethinat-Bashkia Shkodër, me sipërfaqe totale 1131 m², (nga të cilat 425 m² objekt, 706 m² truall/ shesh funksional), në pasurinë nr 152/2“. (shtyrë nga mbledhja e kaluar).
8. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës.

Grafiku i mbledhjeve të komisioneve

Nr.	Komisione	Dita	Data	Ora
1	Komisioni i çështjeve ligjore	E mërkure	17.7.2019	10:00
2	Komisioni i shërbimeve sociale, strehimit dhe çështjeve gjinore	E mërkure	17.7.2019	11:00
3	Komisioni i bujqësisë, pyjeve, menaxhimit të ujrave dhe mbrojtjes së mjedisit	E mërkure	17.7.2019	12:00
4	Komisioni i buxhetit	E mërkure	17.7.2019	13:00

Duke ju falenderuar,

KRYETAR



Xhemal BUSHATI